

Shtojca I – Pyetëtori

Vrojtimi i ndërmarrjeve u krye mbi bazën e pyetësorit të paraqitur në vijim, për përgatitjen e të cilit punuan ekspertët e BB, të AMF dhe të INSTAT.

SEKSIONI A: INFORMACION I PËRGJITHSHËM PËR NDËRMARRJEN

A1: Në cilin(cilët) sektor(ë) të ekonomisë ushtron veprimtari ndërmarrja juaj ?

(Intervistues: mund të përzgjidhet më tepër se një mundësi përgjigjeje)

- | | |
|--|--------------------------|
| A. Bujqësi, pyjet, peshkimi | <input type="checkbox"/> |
| B. Industria nxjerrëse | <input type="checkbox"/> |
| C. Industri Përpunuese | <input type="checkbox"/> |
| D. Energjia elektrike, furnizimi me gaz, avull dhe ajër i kondicionuar | <input type="checkbox"/> |
| E. Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve | <input type="checkbox"/> |
| F. Ndërtimi | <input type="checkbox"/> |
| G. Tregtia me shumicë dhe me pakicë; Riparimi i automjeteve dhe motoçikletave | <input type="checkbox"/> |
| H. Transporti dhe magazinimi | <input type="checkbox"/> |
| I. Akomodimi dhe shërbimi ushqimor | <input type="checkbox"/> |
| J. Informacioni dhe komunikacioni | <input type="checkbox"/> |
| K. Aktivitete financiare dhe të sigurimit | <input type="checkbox"/> |
| L. Aktivitete me pasuri të paluajtshme | <input type="checkbox"/> |
| M. Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike | <input type="checkbox"/> |
| N. Shërbime administrative dhe mbështetëse | <input type="checkbox"/> |
| O. Administrimi publik dhe mbrojtja; Sigurimi social i detyrueshëm | <input type="checkbox"/> |
| P. Arsimi | <input type="checkbox"/> |
| Q. Shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale | <input type="checkbox"/> |
| R. Arte, argëtim dhe çlodhje | <input type="checkbox"/> |
| S. Aktivitete të tjera shërbimi | <input type="checkbox"/> |
| T. Aktivitete të familjeve si punëdhënës; Aktivitete të prodhimit të mallrave dhe shërbimeve të pandryshueshme të familjeve për përdorimin e vet | <input type="checkbox"/> |
| U. Aktivitete të organizatave dhe organizmave ndërkombëtare | <input type="checkbox"/> |

A2: Sa është numri i punonjësve në marrëdhënie pune me kohë të pacaktuar në ndërmarrjen tuaj, të ndarë sipas intervaleve të pagave të përcaktuara në tabelën e mëposhtme?

(Intervistues: Gjatë intervistës të sqarohet që informacioni kërkohet për ata punonjës të ndërmarrjes të cilët kanë një marrëdhënie punësimi me kohë të pacaktuar, pra nuk janë punonjës sezonalë apo të angazhuar me një kohë pune të caktuar të çfarëdoshme. Nëse dhënia e informacionit sipas kësaj strukture nuk është e mundur, të merret të paktën numri gjithsej i punonjësve të përhershëm.

Intervale të pagave	Numri i të punësuarve me pagesë
0 - 35.000	
35.000 - 65.000	
65.000	

A3: Pronësia e ndërmarrjes suaj është:

1. Shtetërore buxhetore
2. Shtetërore jo buxhetore
3. Private shqiptare
4. Private shqiptare në bashkëpunim me të huaj, ku pala shqiptare zotëron më shumë se 50 % të kapitalit
5. Private e huaj 100 %
6. Private e huaj në bashkëpunim me shqiptarë, ku pala e huaj zotëron më shumë se 50% të kapitalit

A4: Në cilin vit ka filluar të ushtrojë veprimtari ndërmarrja juaj në Shqipëri? (Intervistues: nëse viti nuk dihet me saktësi kërkoni një vit që i përafrohet vitit të fillimit së veprimtarisë)

--	--	--	--

A5: A keni informacion / njohuri që ekziston në ndërmarrjen tuaj në lidhje me pensionet private vullnetare në Shqipëri.

*(Intervistues: Shëno me x në kuti për secilin rresht. Oriento të intervistuarin që në këtë vlerësim t'i referohet nivelit të informacionit / njohurive që zotërohet prej punëdhënësit në lidhje me sistemin e pensioneve private vullnetare në Shqipëri në përgjithësi, duke e bërë këtë vlerësim sipas modelit të tabelës së dhënë më poshtë. Gjithashtu të vlerësohet edhe niveli mesatar i informacionit/njohurive që i intervistuari mendon se e zotërojnë punonjësit në lidhje me sistemin e pensioneve private vullnetare në Shqipëri. Vlerësimi duhet të jetë **parashikimi / vlerësimi më i mirë**. Veproni njësoj për njohuritë/ ekspertizën e vlerësuar të punëdhënësit dhe punonjësve në ndërmarrjen tuaj në lidhje me pensionet vullnetare dhe profesionale.*

Përshkrimi	Vlerësimi për nivelin e informacionit / njohurive të	Shkalla e vlerësimit të njohurive (nga 1 në 5)*
A keni informacion / njohurive mbi planet e pensionit profesionale në Shqipëri	Punëdhënësit	
	Punonjësve	
A keni informacion / njohurive mbi sistemin e pensioneve private personale në Shqipëri	Punëdhënësit	
	Punonjësve	

**(Intervistues: Shkalla e vlerësimit të njohurive përcaktohet nga 1 në 5, ku 1 i referohet njohurive mjaft të mira e të gjera. Shkalla ka rendin zbritës, ku 3 i referohet nivelit mesatar të njohurive dhe 5 mungesës totale të njohurive).*

A6: A ofron ndërmarrja juaj ndonjë plan pensioni profesional për punonjësit në marrëdhënie pune me kohë të pacaktuar?

1. Po

2. Jo

(Intervistues:

Nëse përgjigjja është Po, atëherë vijoni me përgjigjen për pyetjen A7.

Nëse përgjigjja është Jo, atëherë vijoni me përgjigjet për pyetjet e Seksionit B të pyetësorit).

A7: Ku e keni marrë informacionin për ndërtimin e planit të pensionit profesional?

(Intervistues: Vijo me përgjigjet për pyetjet e Seksionit C të pyetësorit).

SEKSIONI B: PYETJET NË KËTË SEKSION JANË PËR NDËRMARRJET QË AKTUALISHT NUK KANË NDONJË PLAN PENSIONI PROFESIONAL PRIVAT PËR PUNONJËSIT E TYRE

B1: A keni menduar ndonjëherë për të ndërtuar një plan pensioni profesional për punonjësit tuaj?

(Intervistues: Sqaro që pyetja bëhet për të paktën 2-3 vitet e fundit ose nga momenti i punësimit të të intervistuarit, nëse kjo periudhë kohe është më e shkurtër)

Po *(Intervistues: vijo me pyetjen B2)*

Jo *(Intervistues: vijo me pyetjen B3)*

B2: Ndër arsyet e renditura më poshtë, përcaktoni cilat janë ato arsye që nuk kanë bërë të mundur realizimin e tij?

(Intervistues: mund të përzgjidhet më tepër se një mundësi përgjigjeje)

1. Është shumë i kushtueshëm për punëdhënësin

- 2. Lehtësitë fiskale për kontributet e pensionit janë të pamjaftueshme
- 3. Kundërshton ndërmarrja mëmë
- 4. Punonjësit nuk janë dakord
- 5. Janë konsideruar si më të rëndësishme dhënia e përfitimeve të tjera për punonjësit
- 6. Nuk ka besim të mjaftueshëm në sistemin financiar shqiptar
- 7. Nuk ka besim të mjaftueshëm në shoqëritë administruese të fondeve të pensioneve
- 8. Të tjera (*shpjegoni më poshtë*)

B3: A është përmendur ndonjëherë prej punonjësve tuaj apo përfaqësuesve të tyre shqyrtimi i mundësisë që ndërmarrja juaj të ndërtojë një plan pensioni profesional ose vullnetar?

1. Po

2. Jo

3. Refuzoj

Nëse **PO**, shpjegoni më poshtë se çfarë kërkesë kanë paraqitur punonjësit, raportet e kontributeve të kërkuara ndërmjet punëdhënësit dhe punonjësve etj.

B4: Ndër faktorët e renditur më poshtë, përcaktoni cilët janë ato faktorë që duhet të marrë parasysh ndërmarrja juaj nëse kërkon të ndërtojë një plan pensioni profesional për punonjësit e saj?

(Intervistues: mund të përzgjidhet më tepër se një mundësi përgjigjeje)

- 1. Rritja e shkallës së besnikërisë së punonjësve ndaj ndërmarrjes
- 2. Dhënia e mesazhit se ndërmarrja ka një angazhim afatgjatë kundrejt punonjësve të saj
- 3. Nxitja e kursimeve nga ana e punonjësve
- 4. Përfitimi prej lehtësive tatimore
- 5. Të tjera (*shpjegoni më poshtë*)

B5: Ndër faktorët e renditur më poshtë, përcaktoni cilët janë ato faktorë që pengojnë ndërmarrjen tuaj të kërkojë ndërtimin e një plani pensioni profesional për punonjësit e vet?
(*Intervistues: mund të përzgjidhet më tepër se një mundësi përgjigjeje*)

1. Shumë i kushtueshëm për punëdhënësin
2. Trajtimi fiskal aktual për ndërmarrjet në lidhje me kontributet e pensionit është i papërshtatshëm
3. Nuk ka ndonjë përfitim për ndërmarrjen
4. Nuk e duan punonjësit
5. Janë konsideruar si më të rëndësishme dhënia e përfitimeve të tjera për punonjësit
6. Nuk ka besim të mjaftueshëm në sistemin financiar shqiptar
7. Nuk ka besim të mjaftueshëm në shoqëritë e administrimit të fondeve të pensioneve
8. Të tjera (*shpjegoni më poshtë*)

B6: Si mendoni se mund të vepohet për të bindur punonjësit e ndërmarrjes tuaj për të kontribuar në një plan pensioni profesional, nëse ekziston një mundësi e tillë?

(*Intervistues: mund të përzgjidhet më tepër se një mundësi përgjigjeje*)

- | 1. Po | 2. Jo | 3. Refuzoj | |
|--|-------|------------|--------------------------|
| 1. Duke u dhënë informacion të shkruar për mënyrën se si funksionon dhe përfitimet që vijnë prej pensioneve vullnetare private | | | <input type="checkbox"/> |
| 2. Duke u bërë një prezantim për pensionet vullnetare private nga ana e shoqërive të administrimit të fondeve të pensioneve | | | <input type="checkbox"/> |
| 3. Duke i ndërgjegjësuar se pensioni shtetëror mund të mos i përmbushë nevojat e tyre për të ardhura kur të mbushin moshën për pension | | | <input type="checkbox"/> |
| 4. Duke u ofruar përmirësime në lehtësitë tatimore të trajtimit të kontributeve për pensione | | | <input type="checkbox"/> |
| 5. Duke u përmirësuar besimin në sistemin financiar shqiptar | | | <input type="checkbox"/> |
| 6. Duke u përmirësuar besimin në shoqëritë e administrimit të fondeve të pensioneve | | | <input type="checkbox"/> |
| 7. Duke u ofruar mundësinë që një pjesë e kursimeve të tyre pensionale t'u vihet në dispozicion përpara se të mbushin moshën e pensionit | | | <input type="checkbox"/> |
| 8. Të tjera (<i>shpjegoni më poshtë</i>) | | | <input type="checkbox"/> |

B7: Ndër faktorët e renditur më poshtë, përcaktoni cilët janë ato faktorë që ndihmojnë që ndërmarrja juaj të jetë më e interesuar për të nisur një plan pensioni profesional për punonjësit e vet?

(Intervistues: mund të përzgjidhet më tepër se një mundësi përgjigjeje)

1. Rritja e nivelit të të kuptuarit të sistemit të pensioneve profesionale dhe private vullnetare
2. Përmirësimet në ofrimin e lehtësive tatimore për kontributet për pensionet
3. Shqetësimi i punonjësve që pensioni shtetëror mund të mos përmbushë mjaftueshëm nevojat e tyre me të ardhurat, kur të mbushin moshën e pensionit
4. Kërkesa nga punonjësit
5. Përmirësimi i besimit në sistemin financiar shqiptar
6. Përmirësimi i besimit në shoqëritë e administrimit të fondeve të pensioneve
7. Ndërtimi i planeve të ngjashme nga ana e ndërmarrjeve konkurrenente
8. Kufizimet në të drejtat e punonjësve ndaj kontributeve të punëdhënësit në një plan, nëse ata largohen nga puna brenda dy vjetësh nga anëtarësimi në planin e pensionit të ndërmarrjes tuaj
9. Të tjera (*shpjegoni më poshtë*)

B8: A ka patur raste kur një ose më shumë shoqëri administruese të fondeve të pensionit të kenë kontaktuar me ndërmarrjen tuaj për të shpjeguar mbi mundësinë e ndërtimit të një plani pensioni profesional?

1. Jo

2. Po

Nëse PO, tregoni më poshtë cila/t shoqëri

- Shoqëria administruese e fondit të pensioneve Raiffeisen Invest
- Shoqëria administruese e fondit të pensioneve Sigal Life Uniqa Group Austria
- Shoqëria administruese e fondit të pensioneve SiCRED

Nëse JO (Intervistues: vijo me përgjigjet për pyetjet e Seksionit D të pyetësorit).

SEKSIONI C: PYETJET NË KËTË SEKSION JANË PËR NDËRMARRJET QË AKTUALISHT KANË NJË PLAN PENSIONI PROFESIONAL PRIVAT PËR PUNONJËSIT E TYRE

C1: Në cilin vit ka filluar plani i pensionit profesional për punonjësit e ndërmarrjes tuaj?
(Intervistues: nëse viti nuk dihet me saktësi kërkoni një vit që i përafrohet vitit të nisjes së veprimtarisë)

--	--	--	--

C2: A u ofrohet ky plan të gjithë punonjësve në marrëdhënie pune me kohë të pacaktuar?

1. Po

2. Jo

3. Refuzoj

(Intervistues: Nëse JO, kërko shpjegime se cilit/ëve grup/ëve të punonjësve u ofrohet plani dhe ç'pjesë të shprehur në përqindje ndaj totalit të punonjësve të përhershëm përfaqësojnë)

C3: A ofrohet plani pensionit profesional nga shoqëria administruese e fondit të pensionit?

1. Po

2. Jo

C4: Sa është raporti ndërmjet kontributeve të punëdhënësit dhe punonjësit në planin e pensionit?

1. 1:1

2. 1:1 por punonjësi mund të derdhë kontribute shtesë pa përfituar kontribut shtesë nga punëdhënësi

3. 0:1 dhe punonjësve nuk u kërkohet të kontribuojnë

4. Tjetër raport (*shpjegoni më poshtë*)

C5: Si përcaktohen kontributet në plan:

1. Duke i llogaritur si përqindje ndaj pagës bruto

2. Duke i llogaritur si përqindje ndaj të ardhurave gjithsej bruto, ku përfshihen edhe pagesa për orë pune jashtë orarit, shpërblimet etj

3. Duke ofruar kontribut të përbashkët në sasi, pra kur kontributi i punonjësit është mbi një sasi minimale të caktuar, atëherë punëdhënësi i përgjigjet me rritje të kontributit me po të njëjtën shumë, deri në një sasi maksimale

4. Duke ofruar kontribut të përbashkët në përqindje, pra kur kontributi i punonjësit është mbi një përqindje minimale të caktuar, atëherë punëdhënësi i përgjigjet me rritje të kontributit me po të njëjtën përqindje, deri në një përqindje maksimale

5. Duke i përcaktuar si një shumë fikse për secilin interval pagash të punonjësve (*shpjegoni më poshtë*)

C6: Sa është me përafërsi vlera totale e kontributeve të punëdhënësit dhe punonjësve, e shprehur si përqindje ndaj pagave bazë të punonjësve për të cilin paguhen kontributet?

1. Më pak se 2%
2. 2-4% (përfshi dhe 4)
3. 4-6% (4 nuk përfshihet)
4. Më shumë sesa 6%

C7: A ka gjasa që ndërmarrja juaj të shqyrtojë rritjen e kontributeve për pensione në 2/3 vitet e ardhshme?

1. Po (**Intervistues:** shpjego më poshtë dhe vijo me përgjigjet për pyetjet e Seksionit D të pyetësorit).
2. Jo (**Intervistues:** vijo me pyetjen C8)

C8: Cilat janë arsyet që nuk keni ndër mend të shqyrtoni rritjen e kontributeve të pensioneve? (**Intervistues:** mund të përzgjidhet më tepër se një mundësi përgjigjeje)

1. Kushton shumë
2. Nuk favorizohet nga trajtimi aktual fiskal për kontributet e pensioneve
3. Kontributet aktuale konsiderohen të mjaftueshme
4. Të tjera (shpjegoni më poshtë)

C9: Ndër faktorët e renditur më poshtë, përcaktoni cilët janë ato faktorë që mund të bëjnë që ndërmarrja juaj të ndryshojë qëndrim në lidhje me rritjen e kontributeve për pensionet?

(**Intervistues:** mund të përzgjidhet më tepër se një mundësi përgjigjeje)

1. Rritja e nivelit të të kuptuarit të sistemit të pensioneve profesionale dhe private vullnetare
2. Përmirësimet në ofrimin e lehtësive tatimore për kontributet për pensionet
3. Shqetësimi i punonjësve që pensioni shtetëror nuk do të jetë i mjaftueshëm për të përmbushur nevojat e tyre me të ardhurat kur të mbushin moshën e pensionit

4. Kërkesa nga punonjësit
5. Përmirësimi i besimit në sistemin financiar shqiptar
6. Përmirësimi i besimit në shoqëritë e administrimit të fondeve të pensioneve
7. Rritja e kontributeve në planet përkatëse të pensionit profesional nga ana e ndërmarrjeve konkurrenente
8. Kufizimet në të drejtat e punonjësve ndaj kontributeve të punëdhënësit në një plan nëse ata largohen nga puna brenda dy viteve nga anëtarësimi në planin profesional të ndërmarrjes tuaj
9. Të tjera (*shpjegoni më poshtë*)

SEKSIONI D: PYETJE KONKLUDUESE

D1: A mund të jepni një vlerësim për nivelin e besimit që ndërmarrja juaj ka në institucionet e më poshtme financiare

(Interviewues: Shëno me X në kutinë përkatëse dhe për secilin institucion):

Institucioni financiar	Kam shumë besim	Kam besim	Kam besim mesatar	Kam pak besim	Kam shumë pak besim	Nuk di për institucionin
Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare						
Shoqëri administruese e fondit të pensioneve: Raiffeisen Invest						
Shoqëri administruese e fondit të pensioneve: Sigal Life Uniqa Group Austria						
Shoqëri administruese e fondit të pensioneve: SICRED						

D2: Shpjegoni arsyet për nivelin tuaj të besimit të dhënë në pyetjen më sipër

(Interviewues: shëno shpjegimin e dhënë në hapësirën më poshtë).

D3: Çfarë ndihme prisni të keni nga shoqëritë administruese të fondeve të pensioneve ose AMF për të marrë vendimin për të ndërtuar një plan pensioni profesional apo për të bindur punonjësit tuaj që të marrin pjesë në një plan të tillë?

(Intervistues: mund të përzgjidhet më tepër se një mundësi përgjigjeje)

- Të japin më shumë informacion më shkrim
- Të kenë një linjë telefonike të dedikuar për t'iu përgjigjur pyetjeve tuaja
- Të bëjnë një prezantim për drejtuesit
- Të bëjnë një prezantim për punonjësit
- Të tjera (*shpjegoni më poshtë*)

D4: A ka ndonjë çështje në lidhje me pensionet që nuk e kemi trajtuar në këtë pyetësor por që ju mendojnë se duhet të trajtohet?

1. Po

2. Jo

(Nëse PO, shpjegoni më poshtë)

Ju falënderit për kohën dhe përgjigjet tuaja.